



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 113
Prishtinë, më 18 prill 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 PRILL 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Bekim Haxhiu, Hykmete Bajrami, Albin Kurti, Burim Ramadani, Goran Marinković, Arben Gashi, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Afërdita Berisha-Shaqiri, Alma Lama, Jakup Krasniqi, Ismet Beqiri, Adem Grabovci, Ardian Gjini, Muhamet Mustafa, ministri Besim Beqaj dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje me hapat që ka ndërmarrë ministria që ai drejton për hartimin e Projektligjit për sponsorim, Projektligjit për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre dhe Projektligjin kundër huliganizmit dhe dukurive tjera negative në sport.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje me hapat që ka ndërmarrë ministria që ai drejton për hartimin e Strategjisë për masivizim të sportit.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Lirije Kajtazi parashtroi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje me atë se çka ka sjellë për fushën e trashëgimisë kulturore Ligji i ri për Prizrenin. Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se çka është biseduar në takimet e Brukselit me palën serbe lidhur me personat e pagjetur, çfarë qëndrimi është marrë dhe kur pritet konkretizimi i këtyre bisedimeve. Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me borxhin e vjetër, i cili figuron në faturat e KEK-ut, me fokus në faturat e shpenzimeve për komunitetin serb.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputeti Arsim Bajrami parashtroi pyetje për ministren Vlora Çitaku në lidhje me atë nëse ministria që ajo drejton ka ndonjë plan që agjenda evropiane për Kosovën të mos jetë peng i destruksioneve që Serbia i bën procesit të normalizimit të raporteve me Kosovën.

Ministrja Vlora Çitaku iu përgjigj pyetjes së deputetit Arsim Bajrami.

Deputeti Arsim Bajrami parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me zbatimin e rishikimit funksional të Qeverisë sipas ekspertizës së projektit “Freedom”, të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetit Arsim Bajrami.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se pse ministria që ai drejton ka qenë pasive dhe cili është qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë lidhur me të drejtën e përfaqësimit të AKP-së, veçanërisht në çështjen e dy ndërmarrjeve shoqërore, “APIKO” dhe “ILIRIA”, duke i falur, siç tha ajo, ngastrat e këtyre ndërmarrjeve Manastirit të Deçanit.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me veprimet e ministrisë që ai drejton për hetimin dhe tejkalimin e çështjes së mospagesës së pagave për rreth 40 punëtorë të arsimit në komunën e Ferizajt.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur me 4, 5, 10 dhe 11 prill 2013, pa asnjë vërejtje.

* * *

Në vazhdim, deputeti Halit Krasniqi propozoi që në mbledhjen e sotme plenare, si pikë e fundit e rendit të ditës të radhitet - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë.

Kryesuesi Xhavit Haliti kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Lidhur me propozimin e deputetit Halit Krasniqi u deklaruan deputetët: Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të AAK-së, dhe Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

Pas deklarimeve të lartshënuara, kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Halit Krasniqi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 31,
Kundër ----- 17,
Abstenime ----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Halit Krasniqi që në mbledhjen e sotme plenare si pikë e fundit e rendit të ditës të radhitet - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
5. Debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Organet qeveritare për Shoqërinë e informacionit

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Kryesuesi i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

5. Debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me ndërmarrjen “Trepça”.

Kryetari e ftoi përfaqësuesen e Grupit Parlamentar të LDK-së që, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Sadri Ferati, në cilësinë e propozuesit të çështjes, tha se gjiganti “Trepça”, në të kaluarën jo shumë të largët, me dekada ka qenë një promotor i zhvillimit në Kosovë. Deri në fillimin e vitit 2009, nga minierat e “Trepçës” janë nxjerrë 71 milionë tonë xehe me vlerë të përafërt rreth 17,7 miliardë dollarë. Rreth 15 mijë të punësuar me përkushtimin dhe djersën e tyre bënë që “Trepça” ishte një prej eksportuesve më të mëdhenj në ish-Jugosllavi dhe kontribuuesi më i madh në Buxhetin e Kosovës.

Shumica dërmuese e punëtorëve të “Trepçës” dhanë kontribut të madh për shtetin e Kosovës dhe lirinë që ne sot e gëzojmë. Ta kujtojmë edhe sot marshin e famshëm të punëtorëve të “Trepçës” në vitin ‘88, si dhe grevat historike të vitit ‘89.

Shprehim mirënjohjen tonë të thellë për minatorët dhe të gjithë punëtorët e “Trepçës” për këtë kontribut kolosal. Shumica e këtyre punëtorëve dhe patriotëve iu nënshtruan torturave, burgosjeve dhe largimit me dhunë nga puna.

Sot, menaxhmenti dhe punëtorët e “Trepçës” e kërkojnë mbështetjen e Parlamentit, të Qeverisë, të Odës së Veçantë, AKP-së, për të krijuar mundësi që ata me profesionalizmin dhe përvojën e tyre të menaxhojnë me resurset e tyre në interes të punëtorëve, por edhe të shoqërisë kosovare.

Në vazhdim, deputeti Sadri Ferati foli rreth gjendjes aktuale në ndërmarrjen “Trepça”, për rezervat e identifikuar të cilat janë 53 milionë tonë, rezerva këto të mjaftueshme për një prodhim mbi 100 vjet, për numrin prej 1 500 punëtorëve të punësuar, për prodhimin që në vitin 2012, ishte rreth 13 mijë tonë, apo shprehur në vlerë financiare rreth 20 milionë euro, ndërsa konstatoi se tani “Trepça” ka filluar të bëhet një eksportues shumë i rëndësishëm, ndër më të mëdhenjtë në Kosovë.

Plani i punës, i hartuar nga menaxhmenti i “Trepçës” për 3-5 vjetët e ardhshme parashikon mundësinë e trefishimit të prodhimit dhe po ashtu trefishimin e numrit të punëtorëve. Dhe, vetëm në Stantërg dhe Mitrovicë mund të hapen rreth 1 000 vende të reja të punës dhe kuptohet rreth 3 000 të tjera nëpër njësi tjera. “Trepça” tani ka mbetur peng i pretendimeve të shumta të “kreditorëve”, të cilët pretendojnë se ajo nuk i ka shlyer borxhet ndaj tyre. Për këtë qëllim, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ka bërë thirrje publike dhe e ka vendosur një afat 12-mujor për paraqitjen e pretenduesve si kreditorë. Pas përfundimit të këtij afati, Dhoma e Veçantë e ka vazhduar edhe për 12 muaj. Ky proces mund të vazhdojë me vjet, ndërsa “Trepça” mund të stagnojë dhe të dëmtohet nëse nuk i shfrytëzon mundësitë e veta për prodhim dhe zhvillim.

Pas verifikimit të pretendimeve të kreditorëve, organet e drejtësisë duhet t’i fillojnë hetimet se ku kanë shkuar ato para të kreditorëve, të cilat vërtetohen se janë derdhur në “Trepçë”.

Prandaj, duke mos e penguar punën e Dhomës së Veçantë dhe duke ruajtur natyrën e pronës, është e domosdoshme dhe me interes që të miratohet një ligj i veçantë, që “Trepçës” t’i krijohet e drejta e menaxhimit dhe vendimmarrjes së pavarur në mënyrë që disa njësi aktive do të mund të punojnë dhe gjenerojnë vende të punës dhe zhvillim në interes të punëtorëve, por edhe të shoqërisë së mbarë, si për shembull Miniera Stan-Tërg me Flotacionin në Tunelin e Parë, Kompleksi i minierave Artanë - Hajvali, me Flotacionin, në Kishnicë, kompleksi i minierave Bello-Bërdo - Cërnac, me Flotacionin, në Leposaviq, Metalurgjia e Plumbit, Elektroliza e Zingut, Industria Kimike e të tjera.

Është i domosdoshëm një bashkëveprim i Kuvendit, Qeverisë, Dhomës së Veçantë të AKP-së dhe menaxhmentit të “Trepçës” që të gjejnë një model të përshtatshëm për arritjen e këtij qëllimi, theksoi deputeti Ferati

Ministri Besim Beqaj, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se kompetencat e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi kompaninë “Trepça” janë të limituara në nivel të krijimit të politikave afatgjata, të strategjive afatgjata, ndërsa për funksionimin dhe operimin e brendshëm, menaxhimin e saj të përditshëm, vendimet menaxheriale i merr AKP-ja, prandaj do të ishte logjike që sot në debat të ftohej edhe përfaqësuesi i AKP-së.

Ajo çka ne gjatë kësaj periudhe të caktuar kemi bërë është që ta përgatisim bazën ligjore për valorizimin maksimal të këtyre vlerave të resurseve minerare të Kosovës, që nënkupton vendosjen e resurseve, posaçërisht ato të linjtit dhe xeheve të plumb-zinkut në funksion të zhvillimit të mirëfilltë ekonomik.

Ne në këtë kontekst, e kemi sjellë në Kuvend strategjinë minerare të Republikës së Kosovës, për periudhën kohore 2012-2025, e cila definon qartë se përveç funksionalizimit ka edhe përgatitjen e këtij tregu, përgatitjen e fuqisë punëtore dhe vënien në funksion të zhvillimit ekonomik të gjitha resurseve të cilat kanë të bëjnë me aspektet minerare.

Njëkohësisht, ky Kuvend para pak kohe e ka aprovuar Ligjin për minierat e mineraret me nismë të Kuvendit, pra me nismë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, i cili ligj do të mundësojë që Qeveria të hapë edhe procedura të reja, jo vetëm për kompaninë “Trepça”, por edhe për ndërmarrjet e tjera.

Në vazhdim, ai theksoi se ligjet të cilat ne i kemi sjellë këtu në Kuvend, të cilat realisht na kanë mundësuar që “Trepça” të fokusohet në mënyrë shumë të qartë dhe të trajtohet si ndërmarrje shoqërore: janë Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për organizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Më tutje, ai theksoi se kjo ndërmarrje mbetet larg asaj çka ne të gjithë presim, sepse konsiderojmë që duhet të jetë boshti kurrizor i zhvillimit të sektorit minerar dhe kjo është rruga në të cilën ne shpresojmë që AKP-ja konform ligjeve në fuqi brenda një periudhe të caktuar do t’ia sjellë Kuvendit, do t’ia sjellë edhe Qeverisë hapat se si do ta bëjë ristrukturimin e kësaj ndërmarrjeje dhe në çfarë forme e ka idenë për të krijuar një vlerë shtesë.

Është theksuar shumë edhe çështja e punëtorëve të “Trepçës”, punëtorëve të cilët kanë pasur një stazh dhe kanë qenë të larguar. Unë do të them, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, se ne jemi duke shikuar në mënyrë të detajuar që stazhi i punëtorëve, të cilët kanë qenë të larguar në vitin 1989 dhe të cilët kanë qenë ikonë edhe e fillimit të ndërrimeve

demokratike në Republikën e Kosovës, t'u njihet ai stazh nga Qeveria e Kosovës dhe ata t'i marrin të gjitha benefitet, sikur edhe punëtorët tjerë.

Në fund, ministri Besim Beqaj tha se synim i Qeverisë së Republikës së Kosovës është punësimi sa më i madh, krijimi i ndërmarrjeve të qëndrueshme, krijimi i bazës që këto ndërmarrje të jenë partnerë të qëndrueshëm dhe afatgjatë për zhvillimin ekonomik në nivel të vendit, por edhe në nivel ndërkombëtar.

Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se pas një periudhe të gjatë, tanimë “Trepça” është në një fazë krejtësisht tjetër dhe falë ligjit të cilin e kemi aprovuar.

Në vazhdim, ai theksoi se “Trepça” ka qenë nën mbrojtjen e vendimit të moratoriumit të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, e bazuar me një rregullore të UNMIK-ut 2005/48, stërzgjatja e këtij memorandumit ka rezultuar me zhvlerësimin e aseteve me kosto të lartë të mirëmbajtjes, siguri të aseteve pasive, përderisa për asetet aktive memorandumit ka qenë pengesë për tërheqjen e investitorëve, për zëvendësimin e teknologjisë së vjetruar dhe për rritjen e prodhimtarisë.

Duke qenë se kjo situatë ishte e tillë, u mundësua hyrja në fuqi e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara, në nëntor të vitit 2011.

Ai u fokusua në tri çështje: Bordi i AKP-së duhet të inkurajohet që t'i mbështesë të gjitha propozimet e “Trepçës” për projektet kapitale me të cilat synohet të rritet produktiviteti dhe qëndrueshmëria financiare, AKP-ja si administratore e “Trepçës” në pajtim me Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre t'i shtojë kapacitetet njerëzore që ta përgatisë planin sa më të më të realizueshëm për riorganizimin e “Trepçës dhe AKP-ja nuk duhet ta mikromenaxhojë “Trepçën”.

Drejtori menaxhues duhet të ketë edhe kompetenca, edhe përgjegjësi për veprimet e veta, e jo si deri më tani për çdo riprokurim të vogël të marrë pajtim nga një njësi e veçantë, nga një menaxher, apo edhe nga Bordi i AKP-së, dhe ndonjëherë edhe nga Gjykata Supreme, theksoi deputeti Zenun Pajaziti.

Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi janë vonuar në nxjerrjen e një ligji të veçantë për çështjen dhe trajtimin e “Trepçës”, duke pasur peshën e tij në të kaluarën dhe pretendimet për të ardhmen.

“Trepça”, siç e tha edhe ministri, trajtohet si një ndërmarrje shoqërore, pra nuk është kompani publike. Menaxhimin e saj e ka udhëhequr UNMIK-u në një kohë dhe pastaj ka kaluar në kompetencat e AKP-së.

Është çështje që vërtet do trajtim serioz. “Trepça” deri në datën që ju thashë, ka operuar dhe vazhdon të operojë si dy Trepça - “Trepça” e veriut dhe ajo e jugut.

Është shumë indiaktive dhe shumë simptomatike që Qeveria e bën një involvim në menaxhmentin dhe veprimin në punën e “Trepçës”, kur i ndan subvencione dhe subvencionet i kushtëzon që nuk do të marrë as jugu, nëse nuk i merr veriu.

Në vazhdim, ai tha se në veri as Zyra e Auditorit Gjeneral nuk ka arritur të bëjë ndonjë raport asnjëherë, përkundër asaj që në vitin 2011 gojariht i është premtuar se do t'i mundësohet qasja në veprimet, përkatësisht në pasqyrat financiare për ta parë performansën e asaj pjese, realisht kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

Ai më pas theksoi se nga raporti i Auditorit për vitin 2010 dhe të raportit 2011, vërehet se menaxhmenti i ndërmarrjes shoqërore “Trepça” dhe Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ende nuk kanë arritur ta forcojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar të drejtë të funksionimit si tërësi.

Më tej, ai foli për mangësitë të cilat Auditori i konsideron si çështje që do të duhet urgjentisht të adresohen dhe të trajtohen nga organet kompetente.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se “Trepça” pa dyshim që ka qenë dhe mbetet njëra prej ndërmarrjeve më të rëndësishme të vendit tonë, rëndësia e saj nuk kufizohet vetëm në aspektin e ekonomik dhe potencialin e saj prodhues, por shkon deri në rrafshin politik.

Në të kaluarën, “Trepça” ishte institucioni më i rëndësishëm ekonomik dhe prodhues në Kosovë, e cila përbëhej nga një konglomerat prej rreth 40 minierave, fabrikave dhe ndërmarrjeve të ndryshme. Ajo përfshinte një rrjet ndërmarrjesh në të cilat kishte llojllojshmëri të prodhimeve, si dhe në të cilën punonin mbi 20 mijë punëtorë.

Pas suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës nga Serbia, në 1989 filluan të aplikoheshin masat e dhunshme, siç dihet, prandaj me mijëra punëtorë shqiptarë në “Trepçë” i humbën vendet e tyre të punës.

Pas tërheqjes së trupave ushtarake dhe policore serbe, si dhe pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, si dhe instalimit të administratës së UNMIK-ut në vitin 1999, qytetarët menduan se tash ishte koha për rikthimin e lavdisë së dikurshme të “Trepçës”.

Njerëzit me të drejtë pritën që “Trepça” të revitalizohej, ta rifillonte punën dhe punëtorët t’i ktheheshin prodhimit. Por, kjo nuk ndodhi.

Për shkak se “Trepça” ishte ndërmarrja kryesore që mundësonte punësimin dhe mirëqenien e familjeve të Mitrovicës, jo rastësisht pas luftës Mitrovica është qyteti i vetëm në Kosovë, të cilit i është zvogëluar edhe popullsia. Lëvizja “Vetëvendosje” mendon se “Trepça” nuk duhet të privatizohet, sepse ajo e përbën një resurs shumë të vlefshëm në aspektin ekonomik, si dhe shumë të rëndësishëm në kuptimin strategjik.

Më pas, deputeti Konjufca iu referua një analize që kanë bërë ekspertët e Lëvizjes “Vetëvendosje” të kësaj fushe, duke theksuar se nëse në “Trepçë” do të investoheshin rreth 177 milionë euro, e kjo do të mund të bëhej për 2-3 vjet, kjo ndërmarrje do të rivitalizohej, si dhe do të krijoheshin së paku 8 mijë vende të reja të punës.

Nëse e shikojmë prodhimin e “Trepçës” nga perspektiva e tregjeve botërore, kuptojmë se ajo e përbën një potencial tejet strategjik për zhvillim, meqenëse në bursat botërore çmimet e metaleve kanë një rritje progresive të vlerës së tyre, theksoi z. Konjufca.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, në fillim tha se do ta mbështesë mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Fillimisht, ju e dini se Kosova ka pasur Ministri të Energjisë e të Minierave dhe Qeveria aktuale e ka parë të arsyeshme ta heqë. Është tepër interesante të thuhet se nëse në Kosovë vazhdimisht përsëritet se energjia, do të thotë thëngjilli dhe minierat janë pasuritë tona më të

mëdha dhe i ndërtojmë 19 ministri, e nuk kemi ministri të posaçme, e cila merret me këtë temë, është e qartë se tregohet prioriteti, tregohet si janë vendosur prioritetet. Është krejt e kotë të thuhet në foltoren e Kuvendit ose në konferencë për shtyp se Qeveria e ka prioritet të lartë ose prioritet kryesor zhvillimin e sektorit të minierave, e në këtë rast po flasim për “Trepçën”.

Mendoj se nuk ka të bëjë fare me atë realitet për të cilin ne po dëgjojmë këtu që të flitet. Ai më tutje iu referuar fjalës së ministrit të Zhvillimit Ekonomik lidhur me AKP-në, dhe kompetencave të limituara të Qeverisë në relacion me “Trepçën”, për të konstatuar se vetë Qeveria e propozon Bordin e AKP-së.

Në fund, deputeti Gjini tha se shpresojmë që Qeveria do ta prodhojë një ligj brenda 90 ditësh për “Trepçën”, por në të njëjtën kohë edhe më shumë shpresojmë që ai ligj do të jetë ligj i zbatueshëm dhe përmbajtësor.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të KKR-së, tha se nëse e shohim çështjen e statusit të sotëm të “Trepçës”, si ndërmarrje nën administrimin e AKP-së, i ka të gjitha kompetencat dhe është nën kontrollin e Kuvendit të Kosovës.

Dihet se në mars të vitit 2006, asetet e “Trepçës” kanë qenë të vendosura me një vendim nën moratorium, i cili u vazhdua edhe më 26.1.2011 nga Dhoma e Posaçme. Në bazë të kërkesave është marrë vendim dhe disa njësi punuese të “Trepçës” janë liruar nga moratoriumi.

Në vazhdim, ajo theksoi se Kuvendi i Kosovës në vitin e kaluar miratoi pakon e 3 ligjeve të AKP-së, ligje të cilat dhanë definicione më të qarta për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Deputetja Myzejene Selmani kërkoi nga ministri dhe nga AKP-ja që në grupet punuese që janë formuar, siç janë: Grupi punues për çështje të kontabilitetit dhe financave, Grupi punues për caktimin dhe vlerësimin e rezervave të xeheve dhe Grupi punues për çështje ligjore, Grupi punues për menaxhim të çështjeve mjedisore dhe sociale, që të vijnë me një përfundim sa më të shpejtë dhe të përbashkët se cilat njësi apo dhe cilat ndërmarrje tjera, të cilat e përbëjnë “Trepçën”, mund të largohen nga ky moratorium.

Ne duhet të kemi kujdes me vendimet të cilat janë nxjerrë nga Dhoma e Posaçme, të thuhet dhe të dihet saktë kah po shkon “Trepça” dhe kah po shkon Kosova me sektorin minerar, konstatoi ajo.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Justina Shiroka-Pula, Sabri Hamiti, Alma Lama, Time Kadrijaj, Jakup Krasniqi, Salih Morina, Adem Grabovci, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Myzejene Selmani, Muhamet Mustafa, Sala Berisha-Shala, Vjosa Osmani, ministri Besim Beqaj, Ramiz Lladrovci, Sadri Ferati, Albin Kurti, Valbona Dibra, Hashim Deshishku, Xhevahire Izmaqi, Ramë Vataj dhe Bekim Haxhiu**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetët: Nijazi Idrizi dhe Halit Krasniqi deklaruan se diskutimet e tyre do t’i dorëzojnë me shkrim.

Në fund të këtij debati, deputeti Sadri Ferati, në emër të propozuesit të çështjes, e paraqiti tekstin e rekomandimeve.

Lidhur me rekomandimin e paraqitur nga deputeti Sadri Ferati diskutuan këta deputetë: Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; ministri Besim

Beqaj, si dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim rekomandimin e paraqitur nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me ndërmarrjen “Trepça”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 49
Kundër ----- 17
Abstenime ----- 3

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që në afat prej 3 muajsh ta procedojë Projektligjin për “Trepçën” për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Deputetja Xhevahire Izmaqu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Ajo tha se si komision e kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin Ccvil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Deputetja Xhevahire Izmaqu, më pas paraqiti para Kuvendit rekomandimet të cilat janë paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL. Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti. Diskutimi i deputetes Xhevahire Izmaqu është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij raporti.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatinë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Avokatinë.

Ministri **Bajram Rexhepi**, në emër të Qeverisë së Kosovës, tha se ky projektligj ka për qëllim evitimin e pengesave dhe vështirësive me të cilat janë përballur avokatët gjatë ushtrimit të punës së tyre profesionale.

Ai në vazhdim tha se dispozitat në të cilat është ndërhyrë me plotësim-ndryshim janë ato që i referohen organizimit të Avokatisë në nivel vendi, me qëllim të rritjes së efikasitetit të profesionit të avokatisë, dhe janë rezultat i reformës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Republikën e Kosovës.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Avokatinë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, dhe Aurora Bakalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Avokatinë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Avokatinë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 18:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale